



VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE “ DURRES – KURUM SHIPPING “ SH.A I DATES 01.07.2005

Me daten 01.07.2005, ne oren 13.00, ne Tirane ne Ministrine e Ekonomise, I mbajt Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise “ Durres-Kurum Shipping” sh.a, e rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranës, me nr. vendimi 4363, date 26.05. 1993, per te diskutuar e vendosur per rendin e dites se meposhte :

1. Miratimi i raportit te eksperteve te caktuar ne Mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, date 20.05.2005 te kompanise « Durres Kurum Shipping » sh.a, ne baze te te cilit do te behet transferimi i 15.440 aksioneve te shoqerise “ Durres Kurum Shipping “ sh.a nga aksioneri shtet “ Ministria e Ekonomise “ tek aksioneri privat “ Kurum Steel Co. dhe do te vendosen raportet e reja midis dy aksionereve.
2. Marrja e vendimit per transferimin e paketes prej 15.440 aksionesh nga aksioneri shtet tek ai privat dhe percaktimi i raportit te ri te aksioneve midis aksionereve.
3. Te ndryshme.

Vertetohet prezenca e 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise, te perbere nga dy ortakët, shoqeria Kurum Steel Co me 51 % te kapitalit, perfaqesuar nga z. Zeki Kaya, me autorizimin nr. 211 Prot., date 01.07.2005, leshuar nga Presidenti i ortakut “ Kurum Steel Co “ z. Hasmet Bedii Kurum dhe Shteti Shqiptar me 49 % te kapitalit, perfaqesuar nga Z. Vasil Pano, me autorizimin e Ministrit te Ekonomise Z. Anastas Angjeli, nr. 3713/1 Prot., date 01.07.2005.

Gjithashtu ne mbledhje ishin te pranishem :

- Sokol Plani, Drejtor i Pergjithshem i shoqerise “ Durres-Kurum Shipping” sh.a
- Teuta Ustundag, Perkthyes

Mbledhja asistohet nga Noteri, Agim Xh. Robo.

Perfaqesuesit e ortakeve deklarojne se nuk kane ndonje verejtje per te filluar diskutimin e pikave te rendit te dites. Te gjithe te pranishmit deklarojne se jane gati te diskutojne, keshtu qe fillon shqyrtimi i pikave te rendit te dites.

Fillimisht fjalen e merr perfaqesuesi shtetror, z. Vasil Pano, i cili ben nje historik te shkurter te pjeses se zmadhimit te kapitalit te shoqerise prej 15.440 aksioneve te emetuara dhe te pananshkuara deri ne kete moment dhe paraqet qendrimin e ortakut shtet ne baze te shkreses se Ministrit te Ekonomise, nr. 3713/2 Prot., date 01.07.2005.

Perfaqesuesi i ortakut privat Kurum Stel Co, z. Zeki Kaya shprehet dakort per transferimin e paketes se aksioneve prej 15.440 aksioneve me nje vlere prej 160.570.750 lekesh.

2005 R